

RELACION ARKITEKTONIK

Objekti: Vile dy kateshe me bodrum dhe kantine

Trualli ku do te ndertohet villa eshte ne pronesi te zj. Ledi Leka dhe z. Gerdi Leka dhe ndodhet ne fshatin Dobresh ne afersi te qytetit te Tiranes. Projekt-ideja e paraqitur eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e pronareve qe jane njekohesisht dhe investitore. Gjithashtu ky projekt respekton plotesisht studimin urbanistik (PPV) te Bashkise se Tiranes per zonen. Prona sipas studimit eshte truall ndertimi. Po ju jap disa parametra teknike; KSHT eshte 11%, Intensiteti i ndertimit eshte 0.18 dhe lartesia maksimale mbi toke eshte rreth 9 m. Projekti i viles zhvillohet ne dy kate mbi toke e nje nen toke. Ne oborr, i shkeputur nga vila, eshte parashikuar dhe nje ndertim i vogel nje kat qe do perdoret si kantine. Bodrumi eshte parashikuar si nje hapësire e tere multifunkionale. Kjo hapësire eshte parashikuar te ndriçohet dhe ajroset me dritare ne formen e interkapetit. Bodrumi lidhet me katin perdhe nepermjet bllokut te shkalles se qe vazhdon dhe ne katin e pare. Blloku i shkalles eshte i ndricuar ne gjithe nivelet me nje dritare vertikale. Ne katin perdhe jane organizuar kryesisht ambjentet e dites. Hyrja e viles eshte e pozicionuar pothuaj ne qender te faqes lindore per te siguruar nje organizim dhe levizje sa me efikase pa lene menjane aspektin estetik te struktures. Djathtas hyrjes, e gjitha ne dukje, eshte pozicionuar shkalla. Ne te majte ndodhet nje dhome gjumi per nje anetar te moshuar te familjes e pajisur me nyje sanitare. Perballe nepermjet dy dyerve rreshqitese te fshehura ne mur arrime ne hollin e pritjes. Perballe hyrjes ne holl nje vetrate e madhe sa gjithe faqja e murit ofron nje pamje te mrekullueshme te oborrit te pasem te viles. Kjo hapësire plot drite eshte mjaft dinamike per shkak dhe te pozicionit ne qender te shtepise, aty kryqezohen linjat e levizjes nga nje ambjent ne tjetrin. Majtas kalojme ne nje hapësire tjeter ndejtje. Kjo hapësire me intime eshte parashikuar si dhoma e zjarrit dhe televizorit. Ne anen e djathte te korridorit te hyrjes eshte pozicionuar nje nyje sanitare dhe lavanderia. Ne korridorin qe i lidh ato eshte pozicionuar dhe garderoba e perdritshme e shtepise. Ne te djathte te hollit te pritjes gjendet nje studio ne funksion te anatareve te familjes dhe ne vazhdim kalojme ne ambienti e gatimit dhe ngrenies. Keto dy funksione jane parashikuar ne nje ambjent i cili eshte i orientuar perseri nga oborri i pasem i viles. Ne katin e pare te viles jane organizuar dhomat e gjumit ku bie ne sy dhoma e te zoteve te shtepise e cila ka te perfshire brenda dhomen garderobe nepermjet se ciles kalohet ne tualet. Dy dhoma gati simetrike u takojne femijeve dhe nyja sanitare ne korridor eshte e tyre. Ne kete kat ndodhet dhe nje dhome e vogel qe mund te jete studio, dhome miqsh etj. Te treja dhomat e gjumit kane veranda te cilat jane perftuar nga volumetria e viles. Kati i pare eshte i mbuluar me çati. Vila konceptuar me strukture betonarme dhe mure tulle. Tegjitha muret perimetrare do te jene te termoizoluara me sistemin Kapote per te siguruar nje eficiency maksimale termike. Po ashtu kujdes ne kete drejtim do te tregohet dhe per çatine dhe bodrumin. Vetratat kane nje rol kyç ne termoizolimimin e ambjenteve dhe kesisoj do te jene mjaft cilesore. Fasada pjeserisht do te jete e veshur me pllaka guri apo

materiale te ngjashme me te. Te gjitha impjantet jane konceptuar dhe do te realizohen me materiale dhe pajisje moderne dhe cilesore per te siguruar nje jete sa me komode dhe ne harmoni te plote me arkitekturen e struktures dhe pjesen tjeter te mobilimit.

Per sa u tha me siper, mendoj qe projekti ploteson me se miri kerkesat e banoreve te shtepise per nje jete te qete dhe mireqenie ne harmoni te plote dhe me mjedisin ku do te ndertohet.

Shpresoj qe kjo tentative te marre nje vleresim pozitiv duke miratuar lejen per zhvillim.

Per "Erald-G"

Me respekt

Elton Çarçani

Arkitekt